

**NDËRTIMI I
QËNDRUESHMËRISË:**

**TË RINJTË KUNDËR
EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM**

**PËRMBLEDHJE E ESEVE TË TË RINJVE
PËR KRIJIMIN E QËNDRUESHMËRISË TË
KOMUNITETEVE**

Ky publikim është përmbledhje e eseve të dala nga trajnimi tre-ditorë me të rinjë nga komunat e Gjilanit, Prishtinës, Podujevës, Vitisë, Prizrenit, Fushë Kosovës, Pejës dhe Mitrovicës i cili u implementua në Janar 2021 nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë në bashkëpunim me Debate Centre.

Pikëpamjet e shprehura në këtë përmbledhje janë ekskluzivisht të pjesëmarrsve të trajnimit dhe në asnjë formë nuk paraqesin pikëpamjet e QKSS, Debate Centre ose Ambasadës të Mbretërisë së Holandës në Kosovë.

Trajnimi dhe shkrimi e publikimi i këtyre eseve janë zhvilluar në kuadër të projektit “Ndërtimi i Qëndrueshmërisë: Komunitetet kundër ekstremizmit të dhunshëm” i mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Kosovë.



Kingdom of the Netherlands

NDËRTIMI I QËNDRUESHMËRISË: TË RINJTË KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Përmbledhje e eseve të të rinjve për krijimin e qëndrueshmërisë të komuniteteve



Mentor Vrajolli,

Drejtor Ekzekutiv

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Shënim i QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, në kuadër të projektit “Ndërtimi i Qëndrueshmërisë: Komunitetet kundër ekstremizmit të dhunshëm” gjatë Janarit 2021 ka organizuar një trajnim tre-ditorë me të rinjë nga komunat e Gjilanit, Prishtinës, Podujevës, Vitisë, Prizrenit, Fushë Kosovës, Pejës dhe Mitrovicës. Qëllimi i këtij trajnimi ishte t’i ofrojë pjesëmarrësve njohuri më të zgjeruara rreth fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë dhe rëndësisë së qëndrueshmërisë së komuniteteve në parandalim të këtij fenomeni. Në bashkëpunim me Debate Centre, QKSS përmes trajnimit i ofroj pjesëmarrësve njohuri për zhvillimin e mendimit kritik dhe metodat e hulumtimit. Si rrjedhojë, pas konkludimit të suksesshëm të trajnimit, të rinjtë kanë punuar një seri të eseve për tema të ndryshme që lidhen me qëndrueshmërinë e komuniteteve të tyre përkatëse. Përmes këtyre eseve, të rinjtë kanë paraqitur perspektivat e tyre se ku çalojnë komunitetet e tyre të ngushta ose Kosova në përgjithësi në raport me qëndrueshmërinë dhe kanë ofruar perspektiva të ndryshme se si të adresohen mangësitë në këtë drejtim.

Përmes punës tonë me të rinjtë ne e kemi ri konfirmuar rëndësinë e ngritjes së vetëdijes në mesin e tyre dhe nevojën për aktivitete të ndryshme ekstra kurikulare. Të rinjtë në Kosovë janë entuziastë dhe kanë shumë për të ofruar. Nëse ne si shoqëri nuk e përdorim potencialin e

tyre në mënyrën e duhur, cenojmë qëndrueshmërinë e komuniteteve në përgjithësi, e rrjedhimisht rrisim potencialin e ndikimit të fenomeneve të ndryshme siç është ekstremizmi i dhunshëm në shoqëri. Në i inkurajojmë si organizatat e shoqërisë civile, ashtu edhe institucionet e vendit, që t’i shohin të rinjtë si partner në arritjen e qëllimeve të tyre dhe si akterë të rëndësishëm në arritjen e qëllimit tonë të përbashkët: krijimin e një shoqërie të qëndrueshme.

QKSS falënderon për zemërsisht Arta Berisha, Aulona Uka, Biondina Muzliukaj, Blendi Sheremeti, Burbuqe Kastrati, Dea Fetiu, Fleta Qetaj, Flondra Blakçori, Gjenisa Mandal, Leranda Muqolli, Liridona Bislimi, Lorinë Bajrami, Raesa Nikshiqi, Rea Gashi, dhe Xhemajl Berisha për vullnetin dhe interesimin e tyre për tu bërë pjesë e këtij trajnimi, punën e tyre të përbashkët, shkrimin e eseve dhe gatishmërinë e tyre për t’iu bashkuar QKSS-së në këtë fushatë shumë të rëndësishme që thekson rëndësinë e përfshirjes së komunitet në parandalim të ekstremizmit të dhunshëm. Gjithashtu, ne falënderojmë edhe trajnerët e trajnimit tre-ditor Erblin Hoxha, Ardi Shatri dhe gjithë ekipin e Debate Centre, që me profesionalizmin dhe qasjen e tyre të afërt mbështetën të rinjtë përgjatë zhvillimit të aktivitetit.



Raesa Nikshiqi

Përfshirja e komunitetit në luftimin e diskriminimit nëpër shkolla

Diskriminimi në Kosovë ekziston në shumë sfera të jetës, por kur bëhet fjalë për arsimin, fëmijët e komunitetit tonë nuk janë në dijeni se çfarë është diskriminimi. Diskriminimi për fëmijët nënkupton padrejtësi, dhunë ose çdo lloj pabarazie ndaj fëmijëve. Në mënyrë që të punohet për të zvogëluar diskriminimin duhet tu kushtohet vëmendje e veçantë të gjithë faktorëve relevant si trajtimi i barabartë i fëmijëve, edukimi i mirë i fëmijëve dhe luftimi i padrejtësive tek fëmijët.

Prandaj, diskriminimi është sjellje e drejtuar kundër anëtarëve të një grupi, duke sfiduar barazinë e tyre në të gjitha format e jetës shoqërore. Përveç diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike ose orientimit seksual, shpesh ka diskriminim ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta, fëmijëve që vijnë nga familje me status më të ulët socio-ekonomik dhe të ngjashme. Pothuajse në çdo klasë shkollore në Prishtinë, ka raste të shpeshta kur një vajzë apo një djalë i cili për ndonjë arsye refuzohet, përjashtohet nga grupi. Në të njëjtën kohë, ngacmimet, izolimi dhe refuzimi nuk janë të rezervuara vetëm për studentët e «etiketuar» si më ndryshe prej grupit. Shumica e studentëve përjashtohen, refuzohen apo përballen me forma të ndryshme të diskriminimit në ndonjë moment gjatë shkollimit të tyre, sidomos ata që vijnë prej

komunave më të vogla apo vendeve rurale.

Çështjet e diversitetit dhe barazisë janë temat kryesore në sistemet arsimore të shumë vendeve, duke përfshirë edhe Kosovën. Sot, vërehen shumë pasoja serioze që ka shkaktuar pjesëmarrja e ulët e grupeve të marginalizuara në vendimmarrje. Këto pasoja rrezikojnë kohezionin shoqëror, theksohen të diskriminimi në punësim e vërehen deri tek vet përjashtimi prej komuniteteve të marginalizuara. Qasja e kufizuar në procesin arsimor duhet të shihet si një tregues i përkeqësimit të marrëdhënieve midis grupeve në komunitetin tonë dhe si i tillë duhet të shihet si një paralajmërim për Kosovën që të bëjë hulumtime të mëtutjeshme në mënyrë që të parashikojë dhe t'i përgjigjet përkeqësimit të mëtejshëm të kohezionit shoqëror, pabarazisë e padrejtësisë.

Në të njëjtën kohë, gjithnjë e më shumë pranohet se qasja në arsim cilësor është një nga mënyrat më të rëndësishme në të cilat mund të promovohet integrimi i pakicave në shoqëri. Raporti i vitit 2005 i UNESCO-s, “Edukimi për të gjithë”, thekson se “arritja e pjesëmarrjes universale në edukim dhe arsim, në thelb varet nga cilësia e edukimit dhe arsimit në dispozicion”. Në të njëjtën kohë, duhet të kemi parasysh se përpjekjet për investime për

të siguar arsim cilësor duke u angazhuar dhe fokusuar vetëm në programe të përgjithshme, nuk do të ketë të njëjtin efekt në pozicionin jashtëzakonisht të pafavorshëm të fëmijëve romë. Reformimi i sektorit të arsimit kërkon programe dhe aktivitete të specializuara që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e situatës në arsim. Për më tepër, kur është një fjalë për pakicat që kanë përjetuar historikisht diskriminim, programet arsimore duhet të adresojnë gjithashtu çështjen e diskriminimit në mënyrë që efekti të jetë pozitiv, respektivisht të bëhet diskriminim pozitiv, dhe të parandalohen dukuritë si bullizmi, diskriminimi i fëmijëve apo ngacmimi i tyre.

Nga ana tjetër, edukimi dhe arsimi me cilësi të ulët po ndikon në shkallën e lartë të braktisjes së shkollës nga nxënësit romë, e cila pjesërisht është për shkak të joefikasitetit të sistemit shkollor për të siguruar që këta fëmijë të fitojnë aftësitë themelore. Sipas hulumtimeve, nxënësit qëndrojnë më gjatë në shkolla me cilësi të lartë dhe braktisin shkollat me cilësi të ulët. Përfaqësimi i ulët i romëve në nivele më të larta të sistemit arsimor (arsimi i mesëm i lartë dhe i lartë) është pjesërisht për shkak të cilësisë së ulët të arsimit që fëmijët marrin në arsimin parashkollor dhe shkollat fillore, në njërën anë, si dhe mungesa e përkushtimit të shtetit për të edukuar familjet e komunitetit në anën tjetër. Tema e arritjeve arsimore të studentëve romë është hulumtuar jashtëzakonisht rrallë, dhe hulumtimi që ekziston mbi të tregon një nivel të lartë të analfabetizmit në klasat e larta, që është gjithashtu rezultat i edukimit dhe arsimit me cilësi të ulët. Trendi i braktisjes së shkollave nga fëmijët romë, ashkali dhe egjiptian është shumë i lartë, dhe nuk ka asnjë iniciativë serioze për të zgjidhur këtë problem.

Në përgjithësi, cilësia e lartë e arsimit mund të ndihmojë për të kompensuar pabarazitë sociale, për të përmirësuar mësim-nxënien, për të ndihmuar në realizimin e potencialit të fëmijëve dhe përfundimisht për t'i përgatitur ata për integrimin aktiv në shoqëri. Rritja e cilësisë në arsim dhe interenimet për të parandaluar diskriminimin dhe për të krijuar një kulturë të tolerancës janë të nevojshme në të gjitha nivelet e shkollimit në Kosovë. Përveç mësuesve, drejtorja dhe e gjithë shoqëria brenda shtetit luajnë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim, sidomos edukimin e gjeneratave pa elemente të paragjykitimit e diskriminimit, duke forcuar tolerancën brenda komuniteteve e kohezionin shoqëror.

Në nivelin e shkollës, rekomandohet të futet një politikë shkollore që promovon tolerancën, lirinë, mendimin kritik dhe eliminon paragjykimet. Rekomandohet gjithashtu të udhëzohen mësuesit në përkufizime të qarta se çfarë është gjuha e urrejtjes në shkollë, dhe të organizojnë programe dhe trajnime që promovojnë të kuptuarit e të tjerëve dhe zgjidhjen efektive të konflikteve. Në rastin e diskriminimit etnik, një mënyrë e zvogëlimit të paragjykitimeve, e cila ka tërhequr vëmendjen në vitet e fundit, është rritja e ndërgjegjësimit të grupit shumicë për privilegjin e pajustificuar që ata kanë në shoqëri. Shkurtimisht, kjo do të thotë të merresh me të gjitha format delikate të favorizimit të grupit shumicë që janë të pranishëm në shoqëri. Në mënyra të tilla, përveç rritjes së vetëdijes për privilegjin, është e rëndësishme të sigurohet informacion që diskriminimi ndaj një grupi tjetër mund, dhe duhet të parandalohet. Nëse kjo nuk bëhet, grupit shumicë i mbetet një ndjenjë zemërimi dhe zhgënjimi për realizimin e prirjes së tyre për të diskriminuar.



Blendi Sheremeti

Fenomeni i dhunës në shkollat e Prishtinës

Një mjedis i sigurtë shkollor është thelbësor për nxënësit e të gjitha moshave. Pa këtë siguri ata shköputen nga rrjedha mësimore dhe mbesin mbrapa në mësimin e aftësive të nevojshme për një arsimim të suksesshëm. Kur dhuna është pjesë e mjedisit shkollor të gjithë nxënësit preken në një farë mënyre, prandaj kjo çështje paraqet një rrezik në qëndrueshmërinë e një komuniteti. Ky shkrim ka për qëllim të vëjë në pah problemin e dhunës në shkollat e Prishtinës, të dhëna rreth prezencës së këtij fenomeni, ndikimin e saj në stabilitetin shoqëror dhe aspektet apo fushat në të cilat duhet të ndërveprojmë për ta parandaluar këtë dukuri.

Gjendja në shkollat publike të Komunës së Prishtinës sa i përket sigurisë në përgjithësi është shqetësuese. Fenomenet negative të cilat janë të prezente në shkollat e Prishtinës të cilat në mënyrë të drejtpërdrejt çenojnë sigurinë dhe integritetin e nxënësve janë: duhani, alkooli, droga, dhuna, bullizmi etj. Përceptimi i përgjithshëm ndaj çështjes së sigurisë së nxënësve dhe ambientit shkollor dallon mes prindërve, mësimdhënësve dhe nxënësve. Sipas një hulumtimi nga organizata UNDP me fokus në shkollat e Prishtinës, 21% e nxënësve nuk ndihen aq të sigurtë në ambientin shkollor, kurse rreth 47% e prindërve nuk ndihen të sigurtë për fëmijët e tyre në këtë ambient. Ndërkaq një përqindje prej më pak se 10% e mësimdhënësve i shohin shkollat si ambiente jo të sigurtë për nxënësit, ku

si ambientet më të pasigurtë si nga nxënësit dhe mësimdhënësit janë: oborri i shkollës, tualeti dhe kafet afër shkollës. Sipas këtyre statistikave mund të shohim se dallimi më i madh në aspektin e besueshmërisë së shkollave në fushën e sigurisë qëndron mes prindërve dhe mësimdhënësve. Kjo mund të shpjegohet me faktin se mësimdhënësit janë vetë pjesë e sistemit shkollor që mund të arsyetojë besueshmërinë e tyre në ambientin e tyre të punës. Mirëpo një faktor tjetër që poashtu mund ta arsyetojë këtë konstatim është se në raste të paraqitjes së këtyre fenomeneve negative, një pjesë e përgjegjësisë bie mbi mësimdhënësit të cilët e kanë shumë më të lehtë që problemet e tilla ti injorojnë në mënyrë që ta shmangin barrën e adresimit të problemit duke e parë se këto çështje janë mjaft delikate.

Edhe pse dhuna në shkolla është një fenomen i cili ka qenë gjithmonë në një masë i pranishëm, është shqetësuese rritja e prezencës së saj me kalimin e kohës dhe ndryshimi gradual i formës së saj, nga dhuna e mësimdhënësve ndaj nxënësve në dhunë mes nxënësve bashkëmoshatar. Sipas një artikulli, Policia e Kosovës ka evidentuar 175 raste të lëndimeve trupore të nxënësve të shkollave në Kosovë katër muajve të parë të vitit 2019. Fenomeni i dhunës së mësimdhënësve ndaj nxënësve është në rënie mirëpo me kalimin e kohës dhuna mes nxënësve bashkëmoshatar është vazhdimisht në rritje. Kjo formë e dhunës paraqet fenomenin

e bullizmit dhe kur kombinohet me zhvillimin e teknologjisë dhe rritjen e përdorimit të rrjeteve sociale, paraqet një faktor të rëndësishëm negativ i cili ndikon në qëndrueshmërinë e komunitetit duke ndikuar në zhvillimin psikologjik të viktimës dhe izolimin potencial të tij apo saj. Kur flasim për fenomenin e bullizmit në Kosovë në bazë të një hulumtimi nga Pyper të bërë në vitin 2020, bullizmi është më së shumti i pranishëm në shkollat e mesme (58.31%) dhe në shkollat fillore (31.94%). Sipas këtij hulumtimi masat të cilat janë marrë nga ana e prindërve kur fëmijët e tyre janë prekur nga bullizmi kanë qenë kryesisht bisedimi me mësimdhënësin, me nxënësin/en që ka ngacmuar fëmijën, bisedimi me prindërit e nxënësit që ka ngacmuar fëmijën, bisedimi me drejtorin e shkollës dhe në përqindjen më të ulët konsultimi me policinë. Këto masa nuk është se kanë arritur sukses në aspektin afatgjatë, e sidomos kur kemi të bëjmë me bullizmin kibernetik. Arsyeja e këtij konstatimi sipas një artikulli nga Kosovo 2.0 qëndron në atë se bullizmi kibernetik është më problematik për tu përballur për shkak të tendencës për t'i zhdukur faktet.

Çasja e individëve në organet të cilat mund ti ndihmojnë apo të ndërhyjnë në rast të paraqitjes së dhunës paraqet një faktor të rëndësishëm që e karakterizon një komunitet të qëndrueshëm. Vetëdijsimi i qytetarëve për këtë çështje duhet të bëhet qysh herët, prandaj edukimi i nxënësve rreth organeve të cilat janë në shërbim të tyre në rast se përballen me dhunë është esencial. Mirëpo niveli i edukimit të nxënësve në shkollat e Prishtinës në këtë fushë nuk është në nivelin e duhur, kjo mund të shihet në një raport të publikuar nga Policia e Kosovës rreth perceptimit të sigurisë nga nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të Prishtinës, ku shumica e nxënësve të cilët iu janë nënshtruar një pyetësori kanë pohuar se e dinë numrin e policisë, mirëpo kur është kërkuar që ta shkruajnë numrin ata kanë dhënë përgjigje të gabuar duke shkruar numra që nuk i takojnë Policisë së Kosovës apo thjeshtë nuk e kanë ditur fare. Gjithashtu të dhënat e këtij hulumtimi në përgjithësi tregojnë

se dhuna dhe kërcënimet mes nxënësve sidomos përmes rrjeteve sociale janë të përhapura në suaza të konsiderueshme, e si fenomene ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në shëndetin fizik dhe atë mendor të fëmijës.

Çështja e shëndetit mendor në fushën e sigurisë në shkolla paraqet një faktor të rëndësishëm i cili cënon qëndrueshmërinë në komunitet. Një studim në nivel ndërkombëtar vuri në dukje se fëmijët të cilët perceptohen si të ndryshëm për nga raca, pesha, veshja ndryshe, ose për faktin se nuk kanë shumë miq kishin më shumë gjasa të ishin viktimë e dhunës në shkolla, e këta fëmijë raportojnë nota më të ulëta në shkollë, ankesa shëndetësore, ankth, depresion dhe çështje të tjera të shëndetit mendor. Ky shkrim bën ndërlidhjen e bullizmit me fenomene të tjera negative të cilat janë prezente në shkolla dhe cënojnë qëndrueshmërinë shoqërore, ku në përgjithësi konstatohen incidente të abuzimit të nikotines dhe alkoolit nga fëmijët që janë ngacmuar si përgjigje e traumës që kanë pësuar.

Dhuna në shkolla paraqet një faktor shqetësues, deri diku të neglizhuar, i cili cënon qëndrueshmërinë në komunitet në përgjithësi. Roli i shoqërisë tonë në këtë fushë duhet të jetë i karakterit preventiv e jo vetëm korrektues. Mungesa e besueshmërisë së nxënësve për raportimin e këtij fenomeni, mostrajtimi i tij nga ana e mësimdhënësve dhe prindërve, angazhimi i ulët nga organet kompetente, mungesa e hapsirës për disuktimin dhe vetëdijësimin e fëmijëve për këtë çështje mund të merren si faktor që rrisin dhe normalizojnë praninë e dhunës në shkolla. Prandaj për ta trajtuar dhe parandaluar këtë fenomen duhet të bëhet organizimi i takimeve vetëdijësuese me nxënës me qëllim të vetëdijësimit të tyre mbi raportimin e dukurive negative në shkollë, tek prindi apo tek policia, stimulimi dhe normalizimi i takimeve të nxënësve me psikologët e shkollave si dhe komunikimi më i shpeshtë me Policinë dhe përfshirja e tyre më aktive në parandalimin e dukurive negative në shkolla.



Rea Gashi

Përballja e komunitetit me dhunën ndaj gruas

Të duhet një kërkim i thjeshtë në internet për të kuptuar që dhuna ndaj gruas apo në baza gjinore është një ndër fenomenet më të shëmtuara që një kohë të gjatë në Kosovë. Ani pse ka qenë prezente për aq sa ka ekzistuar edhe vetë mendësia patriarkale, dhuna në baza gjinore duket se ka mbetur në nivelet e njëjta pavarësisht ndërhyrjes së shtetit për parandalimin e saj apo përmirësimeve ligjore. Rritja e numrit të raportimeve të sulmeve ndaj gruas në Policinë e Kosovës ose në instancat tjera të institucioneve të zbatimit të ligjit pa dyshim që ndihmoi në identifikimin e rasteve potenciale, mirëpo dhuna ndaj gruas dhe dhuna në familje në përgjithësi ende mbeten pak të raportuara në krahasim me kërcënimin që paraqesin jo vetëm ndaj komunitetit, por edhe në nivel nacional.

Duke parë efikasitetin e ulët të institucioneve të shtetit për parandalim të dhunës ndaj grave dhe vajzave, është më se e qartë që kjo çështje nuk është adresuar në mënyrën e duhur dhe serioze. Faktori i cili është anashkaluar më së shumti në këtë drejtim është komuniteti dhe roli i tij si baza e një shoqërie të shëndoshë. Mungesa e bashkëpunimit të komunitetit me institucionet shtetërore si dhe aktivitetet e pakta vetëdijësuese të komunitetit për parandalimin e rasteve të dhunës ndaj grave kanë reflektuar dukshëm në strategjitë e mangëta të shtetit në luftën ndaj këtij fenomeni.

Marrë parasysh se shumica e problemeve që janë të lidhura me dhunën në baza gjinore janë të thelluara në norma, komuniteti është pikërisht vendi ku këto norma mund të ndryshojnë e të marrin kahje tjetër. Identifikimi i formave të dhunës në baza gjinore bëhet më i lehtë kur eksplorohet në komunitete si dhe ndryshimet pozitive kanë impakt më të madh kur punohet direkt me komunitetin. Në këtë mënyrë, adresimi i dhunës në baza gjinore duhet që patjetër të kontekstualizohet për të identifikuar saktë formën e dhunës, qoftë fizike, seksuale, psikologjike, ekonomike apo tjetër.

Për më tepër, mos raportimi i dhunës si pasojë e stigmatizimit ose kërcënimit të viktimave tregon për qindra e mijëra raste të izoluara të dhunës të cilat janë shpesh edhe vështirë të identifikohen. E gjitha kjo vështirësohet edhe më tepër në kushtet të cilat na janë imponuar nga pandemia COVID-19. Izolimi brenda katër mureve me partnerë ose anëtarë të familjes abuziv e vështirëson dhe ndonjëherë e pamundëson kërkimin për ndihmë në rastet e dhunës fizike, seksuale apo tjetër. Këtë e dëshmon më së miri edhe trendi global i rritjes së dhunës në familje dhe në baza gjinore, trend të cilin e ndoqi edhe Kosova. Me ngritjen e valëve të reja të pasigurisë ekonomike, çrregullimeve mendore dhe abuzimit me substanca të ndryshme, rriten predispozitat për ngritje të rasteve të dhunës në familje. E duke marrë parasysh që viktimë të

dhunës në familje janë kryesisht gratë dhe vajzat, shpërfaqë një kërcënim të madh të sigurisë në shoqëri.

Në komunitetet ku jetojmë, edhe nëse nuk kemi hasur drejtpërdrejtë në ndonjë rast të dhunës në familje, kjo nuk do të thotë që nuk ekziston. Në fakt, bazuar në të dhëna zyrtare, vetëm rajoni i Prishtinës përfshinë gjithsej 680 raste të raportuara në Polici në vitin 2020, prej të cilave janë shënuar 544 viktima të dhunës në familje që janë vajza dhe gra. Ndërsa nëse flasim në nivel nacional, të dhënat e Policisë së Kosovës të vitit 2020 tregojnë se kanë qenë gjithsej 2101 raste të regjistruara të dhunës në familje në Kosovë, prej të cilave janë evidentuar 1 mijë e 632 viktima vajza dhe gra, ku shtatë prej tyre përfunduan me fatalitet.

Mirëpo as këto statistika e lajme nuk mjaftuan që dhuna në familje dhe në baza gjinore të konsiderohej si temë diskutimi dhe arsye për vetëdijesimin e komunitetit nga ana e mediave. Qëllimi kryesor i politikave për luftimin e dhunës në baza gjinore është që ajo të mos mbetet vetëm diskutim por të implementohet edhe në praktikë. E për ta arritur këtë, nuk mjaftojnë vetëm organizatat e shoqërisë civile e aktivistët, por duhet që në luftën kundër dhunës në baza gjinore patjetër të bashkëngjiten edhe politik-bërësit, duke qenë instrumenti kryesor në implementimin e politikave që reflektojnë në arritjen e barazisë gjinore. Bazuar në një monitorim të përfaqësimit gjinor në panelet e diskutimit të transmetueseve nacional gjatë vitit 2020 nga *truAktiv*, nuk ka pasur asnjë emision kushtuar dhunës ndaj grave gjatë pandemisë në transmetuesin publik *RTK*. E njëjta mungesë është vërejtur edhe në emisionet në TV-të tjera nacionale. Përgjatë kohës sa diskutohej në emisione televizive për aktualitete politike, në anën tjetër ushtrohej dhunë sistematike ndaj grave dhe kjo fatkeqësisht nuk morri vëmendjen dhe hapësirën që meritonte. Është shumë vështirë që të arrihet progres në këtë drejtim përderisa mediat nuk kontribuojnë në edukimin e komunitetit duke e ndërruar narrativin e raportimit për rastet e dhunshme dhe nuk japin mundësinë dhe hapësirën e nevojshme për ta

zgjedhur këtë problem i cili ka efekt në të gjithë komunitetin.

Viti 2020 ka qenë një vit sfidues i cili shpërfaqti të metat e shumta të shërbimeve sociale dhe ndërhyrjes së mangët të shtetit në ofrimin e sigurisë. Edhe pse të gjitha rajonet janë të prekura nga ky fenomen, kryeqyteti i Prishtinës mbetet më i ndikuari nga dhuna në familje dhe dhuna në baza gjinore. Strehimorja për viktimat e dhunës në familje në Prishtinë mbetet vendi ku marrin shërbime banorë nga tetë komunat, mirëpo kjo strehimore është më së paku e financuar përkundër numrit të madh të banorëve që strehon dhe rrezikon që mos të pranoj më viktima të reja për shkak të borxhit ndaj shërbimit të distributorit të energjisë së Kosovës, KEDS. Përveç kësaj, një element që do të ndikonte pozitivisht në identifikimin e hershëm të ciklit të dhunës dhe parandalimin e saj janë diskutimet grupore në komunitete ndërmjet personave kompetent dhe qytetarëve, me fokus të veçantë tek të rinjtë dhe gratë. Edhe pse dhuna në baza gjinore nuk njihet kufij social apo ekonomik dhe mund t'i prek të gjitha gratë dhe vajzat nga të gjitha prapavijat, megjithatë ekziston një rrezik i shtuar dhe siguri e cenuar tek gratë dhe vajzat me pozitë më të ulët socio-ekonomike si pasojë e pabarazisë gjinore. Mbikëqyrja dhe monitorimi i komuniteteve është i domosdoshëm për një qasje të drejtë ndaj grave dhe vajzave në shoqërinë tonë. Gjithashtu, është e rëndësishme që shërbimet klinike për dhunën në baza gjinore të jenë të qasshme edhe në institucionet shëndetësore të nivelit më të ulët, si për shembull qendrat e mjekësisë familjare, me rëndësi të veçantë në zonat rurale duke marrë parasysh qasjen e vështirë të banorëve në këto shërbime. Së fundmi, gjëja kryesore që do të përmirësonte nivelet e dhunës në baza gjinore është një qasje serioze institucionale nga personat kompetent dhe duke dhënë dënime meritore për kryesit e veprave penale sepse rastet e shumta të dhunës dhe vrasjeve të grave dhe vajzave në dekadën e fundit dëshmuar që kjo çështje është politike dhe duhet të fillojë të adresohet si e tillë në mënyrë që të ofrohet siguri dhe drejtësi për vajzat dhe gratë në shoqërinë tonë.



Arta Berisha

Komunitetet përballë përplasjeve politike

Shoqëria kosovare është tejet e politizuar. Neutralët apo përkrahësit e partive politike, të djathtët e majtët, pozitën e opozitën, i bashkon diskutimi për politikën dhe sfidat me të cilat përballtet komuniteti. Debati rreth politikës ashpërsohet me afrimin e zgjedhjeve, ku dallimet politike të shoqërisë vihen edhe më në pah. Për politikë, nuk diskutohet vetëm në debate televizive, por edhe në instanca shoqërore dhe si rrjedhojë, në periudhën e mbajtjes së zgjedhjeve në Kosovë vërehet polarizim i skajshëm politik e shoqëror.

Qytetarët e rëndomtë, anëtarët dhe përkrahësit e subjekteve politike tentojnë që në mënyrë direkte dhe indirekte të ndikojnë tek votuesit e rinj, por edhe te ata neutralë e jostabilë duke kërkuar përkrahjen apo votën e tyre. Si duket në kohë pandemie, mënyra më e mirë për të pasur ndikim te votuesit, përveç pjesëmarrjes televizive, kanë qenë edhe postimet në platformat sociale të komunikimit si: Facebook, Instagram e Twitter. Preferencat politike dhe simpatia për liderë të caktuar politikë dhe kundërshtimi i rivalëve politik, vazhdon të krijoj polarizim brenda shoqërisë dhe komunitetit. Këtu nuk mungojnë edhe debatet brenda familjeve, ku preferencat e ndryshme politike e partiake bëhen mollë sherri mes anëtarëve të familjes. Ky tension shfaqet edhe në rrjete sociale me fyerje, sharje e sarkazëm përmes komenteve ndaj të afërmeve, shoqërisë e të panjohurve, në profile e faqe të

ndryshme. Madje, sipas hulumtimit “Ndikimi i Gjuhës së Urrejtjes si Mjet Politik në Rininë e Kosovës”, të kryer nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES) thuhet se polarizimi politik i shprehur përmes gjuhës së urrejtjes nga komuniteti, është rezultat i mënyrës se si politikanët u referohen kundërshtarëve të tyre politik në paraqitjet publike. Për më shumë, rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se gjuha e urrejtjes nënkupton shprehje apo gjuhë që përdoret për të ofenduar, turpëruar, apo diskriminuar një individ apo grup bazuar në dallimet e tyre të kombësisë, etnisë, racës, orientimit politik apo seksual, por duke mos u limituar vetëm në këto dallime .Pjesëmarrësit që ishin pjesë e hulumtimit menduan se gjuha e urrejtjes përmban shprehje të cilat në të shumtën e rasteve përdoren nga liderët politikë ndaj kundërshtarëve të tyre politik, të cilat rrisin polarizimin politik në shoqëri e komunitet dhe rrisin potencialin për dhunë ndërmjet komuniteteve në Kosovë. Në përgjithësi, pjesëmarrësit argumentuan se liderët politikë përdorin gjuhën e urrejtjes me qëllim të arritjes së qëllimeve të tyre individuale e politike, për t’u paraqitur më superiorë karshi rivalëve të tyre politikë.

Përmes këtij diskursi komentuesit e rrjeteve sociale apo diskutimeve për politiken, tentojnë t’i arsyetojnë të preferuarit e tyre politik, dhe t’i sulmojnë ata që e përkrahin një parti tjetër. Por, e

përbashkëta e këtyre komentuesve që përplasen virtualisht për tema rreth politikës është se secili aspiron që kur partia që ata e përkrahin të jetë në pushtet do të punojë për të mirën e komunitetit, duke filluar nga plotësimi i nevojave bazike e deri te çështjet e mëdha.

Pavarësisht polarizimit të madh politik e ndërrimit të shpeshtë të qeverive, shumica e qytetarëve janë të zhgënjyer dhe të pakënaqur me punën dhe qeverisjen e institucioneve të vendit qoftë në nivel nacional, qoftë në atë lokal. Qytetarët e Kosovës ende përballen me mungesë të energjisë elektrike, mungesë të ujit, ndotje të ajrit dhe të tokës, me nivel të dobët të arsimit e me papunësi të lartë, me vullnet për punë e me mungesë të vizave, me korrupsion e nepotizëm, me sistem «të sëmurë» shëndetësor.

Brishtësia e sistemit shëndetësor dhe keq menaxhimi i tij si rrjedhojë e politikave të gabuara është vërejtur tash e një vit gjatë përballjes me pandeminë e shkaktuar nga virusi Korona COVID-19 në Kosovë. Tërë këtë periudhë, nga java në javë, nga muaji në muaj është eksperimentuar me kufizimin e lirisë së lëvizjes për qytetarët, si dhe me kufizimin e orareve dhe kushteve të punës për bizneset. Qytetarët dhe bizneset që i kanë shkelur rregullat e karantinës dhe kufizimeve janë gjobitur me shuma të papërballueshme për

standardin jetësor në Kosovë. Në anën tjetër, gjatë fushatës zgjedhore ishin vetë partitë politike që mblodhën në tubime numër masiv të qytetarëve, pa i respektuar masat mbrojtëse dhe kufizimet për pandeminë. Përballja me pandeminë e shkaktuar nga COVID19 ka shkatërruar ekonominë e vendit si dhe ka ndikuar që mbi 50 qytetar të humbin vendet e tyre të punës. Mijëra biznese kanë falimentuar dhe rënia ekonomike e vendit pritet të jetë mbi 7 %. Pandemia ka shkatërruar sistemin edhe ashtu të dobët të arsimit dhe të shëndetësisë në vend. Për më shumë, pandemia ka vënë në pah qeverisjen e keqe me të cilën përballlet vendi për më shumë se 20 vite.

Polarizimi politik, mungesa e një vendi të qëndrueshëm të punës, qeverisja e keqe dhe besimi i ulët në institucione, prezenca e kriminit e korrupsionit në sektorin publik, po ndikon në humbjen e shpresës së komunitetit në vend, rritë përplasjet politike ndërmjet taborëve të ndryshme politike, duke rritur potencialin për dhunë ndërmjet shoqërisë dhe komuniteteve në Kosovë. Urgjentisht duhet të rritet besueshmëria dhe ndërveprimi ndërmjet institucioneve shtetërore dhe komunitetit në vend, e cila duhet të vazhdohet me rritjen e kualitetit të qeverisjes duke përmirësuar kushtet e jetesës në vend. Kjo do të ishte ndër mënyrat më të mira për forcimin e kohezionit social e shoqëror në vend dhe reduktimin e dhunës në nivel komuniteti.



Burbuqe Kastrati

Zhvillimi i integruar ekonomik lokal si faktor për qëndrueshmëri afatgjate tek të rinjtë

Në vendet në zhvillim siç është Kosova, kapitali njerëzor është një nga faktorët kyç për zhvillimin ekonomik. Duke marrë parasysh që Kosova karakterizohet me popullsinë më të re në Evropë, potenciali i zhvillimit të kapacitetit njerëzor është shumë i lartë. Pra, kjo paraqet një panoramë ekonomike se si në vitet në vazhdim do kemi rritje të konsiderueshme të moshës së punës apo kërkesë të madhe për punësim. Ajo çka vërehet në Kosovë është se ka një disbalancë mes strukturës shoqërore dhe bazës ekonomike apo nevojave të tregut të punës. Sipas raportit të UNDP të bërë mbi zhvillimin njerëzor në Kosovë, del që 61% është shkalla e papunësisë tek të rinjtë, e që është thujse dyfishi i normës së përgjithshme të papunësisë në Kosovë. Poashtu, aty vërehet edhe dallimi i madh apo hendeku gjinor, ku del të jetë përqindja më e madhe në rajon, pra, shkalla e papunësisë së grave të reja është jashtëzakonisht e lartë prej 71.7%. Duke marrë parasysh që rolet gjinore në ambientet e shtëpisë në shoqërinë tonë vazhdojnë të jenë të theksuara, shumica e këtyre grave heqin dorë nga puna dukë marrë përsipër rolin e kujdesit mbi familjen. Kurse jo rrallë herë,

dhe ato që janë brenda tregut të punës punojnë me orar të pjesshëm. Ky realitet ekonomik e bën tregun e punës sfidues për shumë pjesëtar të shoqërisë dhe kontribuon në paqëndrueshmërinë brenda strukturës shoqërore në vend. Raporti i Bankës Botërore për Kosovën potencon fenomenin e koncentrimit të madh gjeografik të ndërmarrjeve ekonomike. Pra, rreth 35% të firmave/ndërmarrjeve janë të vendosura në Prishtinë dhe me 16% në Prizren.

Zhvillimi ekonomik perceptohet vetëm si përgjegjësi e nivelit qendror qeverisës. Përtej buxhetit që i dedikohet komunave nga Kuvendi, dhe politikave ekonomike që Qeveria implementon, komunat kanë të drejtë ligjore që të zhvillojnë politika jo veç në fushën e ekonomisë por edhe në shumë fusha tjera. Në Strategjinë për Zhvillim Lokal 2019-2023 të publikuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, parashihet ngritja e kapaciteteve dhe koordinimi i politikave për zhvillim lokal. Për më tepër, strategjia përmban objektiva që synojnë të stimulojnë zhvillimin si: rritja e qëndrueshme financiare e komunave, tërheqja e investimeve

të huaja, fuqizimi i ekonomisë lokale përmes investimit në kapitalin njerëzor, shfrytëzimi i resurseve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Kjo strategji do i ndihmonte shumë komunave të krijojnë një ambient të përshtatshëm për rritje ekonomike dhe zhvillim, duke i përdorur resurset natyrore lokale dhe njerëzore, që do e stimulonin zhvillimin e duhur lokal dhe do e luftonte koncentrimin e ndërmarrjeve biznesore vetëm në disa pjesë të caktuara të vendit, ku vështirësohet qasja e të rinjëve në mënyrë të barabartë në tregun e punës. Rasti i Parkut Inovativ në komunën e Prizrenit, i ardhur si marrëveshje mes Qeverisë së Kosovës dhe Gjermanisë për transformimin e bazës ushtarake gjermane në Park Inovacioni për të i ndihmuar bizneset dhe sektorët me potencial zhvillimor në fushat e teknologjisë, bujqësisë dhe e turizmit është një shembull suksesi i bashkëpunimit që krijon hapësirë dhe infrastrukturë të përshtatshme për bizneset. Aftësia për të shfrytëzuar kapacitetet lokale për zhvillim dhe punësim duke bërë dhe studime fizibiliteti nga organet qeverisëse lokale dhe qendrore është një hap shumë i rëndësishëm dhe vital për zhvillimin dhe qëndrueshmëri ekonomike.

Duke parë hovin e zhvillimit të kompanive teknologjike, njashtu dhe potencialin që ka rajoni i Prizrenit për zhvillimin e turizmit, atëherë kjo do krijonte mundësi të reja në tregun e punës për të rinjtë, rritje e interesimit nga investitorë të huaj dhe infrastrukturë të përshtatshme për ndërmarrjet lokale.

Studimet tregojnë që të rinjtë me shkollim të mesëm profesional kanë shkallë më të lartë të pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, me 43%, ose janë të punësuar ose duke kërkuar punë në vazhdimësi. Kjo ngjallë nevojën e krijimi të qendrave trajnuese për të rinjtë, ku ata do merrnin aftësi profesionale në fusha të ndryshme dhe do kenë qasje në treg të punës qysh në moshë të re. Pra, nevoja e investimeve në sektorin privat dhe ndërmarrësi është e padiskutueshme, por krijimi i mundësive nga institucionet shtetërore është i domosdoshëm. Këto mundësi mund të garantohen

përmes programeve të edukimit formal e joformal ku të rinjtë fitojnë shkathtësi profesionale dhe kjo ua garanton qasjen në tregun e punës qysh në moshë të re. Një fenomen tjetër është se shumë të rinjtë anojnë nga punësimi në sektorin publik. Përmes këtyre punësimeve atyre iu garantohet qëndrueshmëri afatgjate financiare dhe siguri në jetë. Sipas të dhënave të Agjencionit të Statistikave të Kosovës, sektori i arsimit dhe i shëndetësisë del të jetë më së shumti të punësuar me gra dhe vajza (54%), përderisa burrat kryesisht janë të orientuar në sektorin e tregtisë dhe prodhimit (42%). Dallimi i madh gjinor sa i përket orientimeve profesionale nuk është se është zbehur edhe tek gjeneratat e reja. Kjo jo domosdoshmërisht e rëndon ekonominë, por gjithsesi se nevoja e luftimit të stereotipave gjinore në sektorë të ndryshme dhe krijimi i një ambienti ekonomik të qasshëm për të gjithë do ishte më se e nevojshme për një qëndrueshmëri në aspektin ekonomik e social.

Këtu paraqitet domosdoshmëria për krijimin e politikave që do e rrisnin zhvillimin e kapitalit njerëzor e ekonomik në pjesë të ndryshme të vendit, do e ulnin varfërinë dhe do e siguronin rritjen e barabartë. Mungesa e resurseve financiare, mos planifikimi i duhur, dhe politikat afatshkurtra janë ndër shumë faktorët që kanë ndikuar në kufizimin e rritjes ekonomike. Komunitat duhet të i përdorin kompetencat ligjore që iu japin të drejtën e krijimit të politikave të caktuara që ndihmojnë zhvillimin lokal. Kjo e drejtë iu garantohet në ligj dhe po ashtu kjo vjen edhe si domosdoshmëri për harmonizim të politikave ndër-institucionale që nevojat e të rinjve në tregun e punës të adresohen në mënyrë më efikase. Krejt kjo përqindje e lartë e papunësisë tek të rinjtë që vërehet të jetë prezentë në tërë vendin dhe ky mos aktivitet i të rinjve paraqet një potencial të humbur e të pashfrytëzuar që e privon vendin nga një zhvillim i qëndrueshëm ekonomik dhe arritjen e mirëqenies sociale. Këta faktorë shtyjnë të rinjtë që zgjidhjen ta gjejnë tek migrimi, dhe ajo çka po haset të ndodhë është që Kosova po prodhon gjenerata të humbura apo ikjen e trurit "brain drain" të shoqërisë me politika jo të duhura ekonomike apo edhe mos implementim të tyre.



Lorinë Bajrami

Përballja e komunitetit me dhunën në familje

Në një shoqëri ideale, familja është njësi themelore e saj dhe mjedisi ku çdo individ duhet të ndihet i lirë dhe i sigurt. Megjithatë, në Kosovë realiteti familjar nuk jep ndjenjën e sigurisë dhe lirisë dhe fatkeqësisht, për disa individ, familja shpesh shërben si mjedis abuzues. Dhuna është elementi që shton errësirë në çdo mjedis e më se shumti në familje. Në të drejtën tonë pozitive, sipas ligjit nr.03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje, i cili shërben si burim për aktgjykimet finale të sistemit gjyqësor të Kosovës, dhuna njihet si përdorim i forcës fizike ose presionit psikik i një personi me qëllim të kanosjes, shkaktimit të frikës, shtytjes ndaj një personi tjetër me të cilin ka ose ka pasur lidhje familjare. Motivet dhe veprimet që shkaktojnë përgjegjësinë e këtij personi sipas ligjit të lartëcekur, përshkruhen por nuk kufizohen në: sulm fizik pa marrë parasysh pasojat, sharje apo forma të tjera të ofendimit të cilat cenojnë dinjitetin e viktimës, keqtrajtime për motive seksuale, veprimet të cilat cenojnë privatësinë, jetën, lirinë, të ardhurat, dhe jetën profesionale të tjetrit.

Dhuna në familje ka qenë e pranishme në shumicën e familjeve kosovare dhe përkundër punës së akterëve relevant kundër dhunës, ajo vazhdon të mbetet njollë e zezë në shoqërinë tonë patriarkale. Sipas një publikimi të Rrjetit të Grave të Kosovës, 62% e kosovarëve kanë përjetuar dhunë në familje një apo me shumë herë gjatë jetës së tyre. Kurse, vetëm përgjatë vitit 2014, 31% e kosovarëve kanë

qenë viktime të dhunës në familje. Statistikisht, gratë janë më të ekspozuara ndaj dhunës në familje se sa burrat, ku vetëm gjatë vitit 2017 nga të gjitha rastet e raportuara, 76% ishin raportime nga gratë kurse pjesa e mbetur e raportimeve ishin nga burrat. Përveç grave, viktime të dhunës në familje janë edhe fëmijët. Fatkeqësisht, shumë prej familjeve në komunitetin tonë përdorin dhunën si mënyrë disiplinimi për fëmijët. Sipas një raporti të vitit 2014 të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), 61% e femijëve kanë përjetuar dhunë psikologjike ose ndëshkim fizik gjatë muajit të fundit [para realizimit të anketës]. Gjithashtu, sipas statistikave të publikuara nga Policia e Kosovës, raportimi i rasteve të dhunës në familje po shënon ngritje nga viti në vit. Përderisa gjatë vitit 2017 janë raportuar 1269 raste të dhunës në familje, në vitin 2018 janë raportuar 1541 raste. Në anën tjetër, gjatë vitit 2019 ky numër pati ngritje me 1915 raste të raportuara në Policinë e Kosovës. Rastet e dhunës në familje kanë pësuar rritje shqetësuse gjatë pandemisë COVID-19. Gjatë prillit të vitit 2020 rastet e raportuara të dhunës në familje janë rritur për 21% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Sidoqoftë, hulumtimet e ndryshme tregojnë se numri i rasteve të raportuara të dhunës në familje është shumë më i lartë sesa ato të raportuarat. Zakonisht rastet mbesin të raportuara si pasojë e perceptimit që dhuna në familje është çështje private dhe si pasojë e stigmatizimit dhe turpërimit të viktimave në

opinionin publik. Sipas Rrjetit të Grave të Kosovës, bashkëpunimi mes mediave dhe organizatave jo-qeveritare ka shumë rëndësi në parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje. Mediat luajnë rol të jashtëzakonshëm në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve dhe promovimin e rëndësisë të raportimit të dhunës në familje.

Kur flasim për raportimin e dhunës në familje, zakonisht, Policia e Kosovës është dera e parë që viktimat e dhunës në familje trokasin. Fatkeqësisht, gjatë viteve të fundit kemi raste kur viktimat kanë hasur në vesh te shurdhër dhe ankesat e tyre janë injoruar nga ana e institucioneve të sundimit të ligjit. Neglizhenca e institucioneve theksohet në rastin e vrasjes së Zejnepe Bytyqit, Valbona Ndrecajt etj. të cilat pavarësisht raportimit të vazhdueshëm të dhunës në familje, nuk janë trajtuar në mënyrë adekuate nga institucionet e zbatimit të ligjit. Në anën tjetër, duke marrë parasysh dominimin e mendësisë patriakale në Kosovë, opinionin publik ndan përceptime të dëmshme dhe shqetësuese për fenomenin e dhunës në familje. Sipas hulumtimit të vitit 2014 të ASK-së, 42% e grave dhe 22% e burrave mendojnë se burri ka arsye ta godas ose ta rrahë gruan e tij nëse ajo del pa i treguar atij, nëse ajo i neglizhon fëmijët, nëse ajo fjaloset me të ose refuzon të kryej marrëdhënie seksuale me të etj. Në anën tjetër, rezultatet e Barometrit Kosovar të Sigurisë, program ky i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë, tregojnë se 69% e qytetarëve të Kosovës nuk e shohin dhunën në familje si rrezik në Kosovë.

Për trajtimin e viktimave të dhunës në familje, në

Kosovë janë hapur shtatë strehimore në Gjakovë, Ferizaj, Prishtinë, Pejë, Gjilan, Prizren, dhe Mitrovicë të Jugut. Mesatarisht, këto strehimore mund të strehojnë nga 15 persona së bashku me fëmijët dhe shumica e tyre ofrojnë edhe shtretër shtesë për situata emergjente. Kohëzgjatja maksimale e qëndrimit të viktimave në strehimore është gjashtë muaj, ku më pas viktimat mund të transferohen në strehimore tjera ose të zgjasin marrëveshjen e qëndrimit. Në anën tjetër, vetëm 17 nga 38 komunitat në Kosovë kanë themeluar mekanizmat komunal të koordinimit me qëllim të përmirësimit të ndihmës që u ofrohet viktimave të dhunës në familje dhe mbështjetjes së strehimoreve për të trajtuar rastet e dhunës në familje. Për më tepër, duke marrë parasysh rritjen e rasteve të dhunës në familje gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, Ministria e Shëndetësisë dhe ajo e Drejtësisë kanë hapur strehimore të përkohshme për karantinimin e viktimave të dhunës në familje.

Për të adresuar fenomenin e dhunës në familje, duhet të ketë më shumë vetëdijësim të shoqërisë. Deri më tash, përceptimi i përgjithshëm i shoqërisë kosovare mbi dhunën në familje ka ndikuar në stigmatizimin e viktimave dhe ka ndikuar në normalizimin dhe izolimin e këtij problemi në rrafsh privat. Mbizotërimi i këtij përceptimi ka reflektuar edhe tek institucionet, të cilat në shumë raste kanë qenë neglizhente ndaj rasteve të dhunës në familje. Andaj, ngritja e vetëdijes dhe bashkëpunimi i mirëfilltë i institucioneve me qytetarët duhet të jetë prioriteti kryesor për adresimin e dhunës në familje dhe përkrahjes më të gjerë për viktimat e këtij fenomeni.



Dea Fetiu

Përballja e të rinjve me papunësinë

Papunësia është një problem i madh në Kosovë, i cili veçanërisht prek mijëra djem dhe vajza të reja dhe ndikon rëndë në mirëqenien dhe jetën e të rinjve. Aktualisht në Kosovë rreth dy të tretat e popullsisë janë në moshë pune, ndërsa 40% e pjesës aktive të tyre janë të papunë. Për më tepër, vërehet një disbalancë e madhe në gjininë e të papunëve duke qenë se numri i grave të papuna është për disa herë më i lartë sesa ai i burrave. Gjithashtu, në treg të punës kemi një pabarazi edhe në aspekt të moshës. Norma e papunësisë të të rinjtë është dy herë më e lartë sesa norma e papunësisë së popullatës në përgjithësi. Në këtë nivel të lartë të papunësisë të të rinjve potencialisht ndikon sistemi i dobët dhe jo orientues arsimor në Kosovë, i cili fatkeqësisht lë hendek në mes të kërkesës dhe ofertës për punë dhe nevojave të tregut të punës.

Sipas ekspertëve të fushës së arsimit, hendeku mes tregut të punës dhe edukimit të të rinjve në vend shihet si një problem shumë serioz, zgjidhja e të cilit kërkon një punë shumë të gjatë në ristrukturimin e sistemit arsimor. Cilësia e mësimin në universitet publike dhe private në Kosovë lë për të dëshiruar, sidomos duke konsideruar se qasja e tyre nuk është e orientuar nga aspekti praktik dhe në shumë fusha nuk përgatisin kuadro të reja në përputhje me kërkesat dhe zhvillimin e tregut të punës. Për më tepër, universitetet kosovare nuk orientojnë të rinjtë në punë praktike që lidhen me profesionin e

tyre, të cilat konsiderohen shumë të suksesshme për përgatitjen dhe zhvillimin profesional të të rinjve. Punëdhënësit shpesh shprehen se kandidatët, edhe pse të diplomuar, shpeshherë nuk tregojnë njohuri themelore në fushat që kanë diplomuar. Kjo tregon se sistemi arsimor në Kosovë nuk përmbush nevojat e studentëve dhe nuk kontribuon në orientimin e tyre në karrierë.

Mungesa e zhvillimit të shkathhtësive të buta, edukimi jo-cilësor dhe mungesa e zhvillimit të mendimit kritik vazhdojnë t'i penalizojnë të rinjtë kosovar në tregun e punës. Këto aspekte do të duhej të zhvilloheshin gjatë shkollimit të lartë përmes programeve të punës praktike dhe orientimit në karrierë për të rinjtë. Për më tepër, niveli i diplomimit në fusha të caktuara në Kosovë nuk përkon me nevojat e tregut të punës dhe vërehet që kemi shumë të diplomuar në degë të caktuara që në realitet nuk gjenerojnë aq vende pune sa për t'i akomodu të diplomuarit çdo vit. Në anën tjetër, degët profesionale ose degë shumë specifike shkencore përballen me mungesa të studentëve, rrjedhimisht krijohet hendek në punësim në ato degë. Këto rrethana kanë instaluar një stigmë karshi drejtimeve të ndryshme profesionale dhe kanë krijuar perceptimin që për të definuar jetën profesionale, individët duhet domosdoshmërisht të kenë një diplomë universitare.

Në këto rrethana, të rinjtë dhe qytetarët në përgjithësi duhet të jenë më të zëshëm në shtytje të reformimit të sistemit arsimor. Një zgjidhje për këtë problem ka filluar të bëjë një grup i madh i organizatave vendore që fokus kryesor të punës së tyre kanë ngritjen e kapaciteteve të të rinjve përmes trajnimeve e ofrimit të punës praktike për ta. Duke shfrytëzuar këto mundësi, shumë të rinj shprehen se janë aftësuar dhe kanë fituar shumë njohuri praktike dhe janë përgatitur për të kërkuar punë. Duke qenë se sistemi aktual i arsimit nuk po i përgatitë të rinjtë për treg të punës, rekomandohet që sistemi të reformohet në atë mënyrë që të përkojë me tregun e punës Kosovare. Kjo zgjidhje së pari përfshin pjesën e transformimit nga mësimdhënia tejet teorike në atë me fokus në praktikë, me qëllim që studentët të mësojnë ta shndërrojnë profesionin e tyre në shkathtësi që

do të ju duhen në punë. Një zgjidhje e tillë mund të arrihet me riformulim të kurrikulave mësimore e bashkëpunim me zyrat e punësimit, në mënyrë që studentët të gjejnë punë praktike të ndërlidhura me profesionin që do të ushtrojnë gjatë studimeve. Së dyti, ristrukturimi i institucioneve të arsimit duke rritur cilësinë dhe vlerën e shkollave profesionale do të ndihmojë po ashtu në zvogëlim të hendekut të kërkesës dhe ofertës për punë. Duke nxjerrë kuadro të reja në shumë prej profesioneve që ofrohen në shkolla të mesme profesionale, përmbushen me punëtorë shumë pozita që janë në mangësi të tyre dhe rrjedhimisht ullet papunësia te të rinjtë. Rinia kosovare ka dëshmuar të ketë shumë potencial për të kontribuar në shoqëri dhe duke reformuar sistemin e arsimit ajo mund ta shndërrojë këtë potencial në kontribut për shtetin tonë.



Xhemajl Berisha

Bullizmi në sistemin arsimor në Kosovë

Në shkolla por jo edhe vetëm, dëgjojmë raste që një person apo edhe disa të tillë trajtohen ndryshe nga të tjerët, në kuptimin negativ, si nga bashkëmoshatarët, mësuesit apo edhe jashtë shkollës, nga rrethi shoqëror apo njerëzit me të cilët ai rrethohet. Se si ata kanë arritur në atë pozitë jo të mirë, mund të ketë përgjigje dhe arsye të ndryshme. Përballja me një atmosferë të tillë zhvillon mundësitë që të ndikojë edhe në sjelljen e tyre ndaj botës dhe ndaj vetvetes. Këta njerëz të rënë pre e sjelljeve të ashpra të të tjerëve, shpesh hynë në kategorinë e të bullizuarëve.

Çështja e bullizmit apo të të bullizuarit është një prej më të ndjeshmeve, sepse përballja me të mund të çoj në drejtime të ndryshme të të menduarit për mënyrën e vazhdimit të jetës. "Bullizmi është shtypje e përsëritur, psikologjike ose fizike e një personi më pak të fuqishëm nga një person ose grup personash më të fuqishëm" - Rigby, 1996. Më pas, se si njeriu i pranon bullizimet varet nga natyra e tij, por meqë të bullizuarit zakonisht janë të dobët kundrejt bullizuesëve, mundësitë për përballimin e ngacmimeve janë jo të mëdha.

Jo çdonjëri i bullizuar ka përjetuar të njëjtat sjellje të tjerëve. Mënyrat e bullizimit janë të ndryshme dhe secila prej tyre ka ndikimin e vet dhe dallojnë në formë dhe rezultat. Si formë e bullizimit përfshihet bullizmi fizik, verbal, social, seksual, virtual, fetar, racial etj. Ashtu siç dallojnë në formë, këto dallojnë

edhe në rezultatin që sjellin tek personat e bullizuar, e cila përveç të tjerash varet edhe nga karakteri i personit të bullizuar dhe cilës prej formave të bullizmit i është nënshtruar.

Në një studim të bërë përmes meta-analizës nga Gini dhe Pozzoli në vitin 2009 me grupmoshat prej 7 deri në 16 vjeç, ku përfshiheshin bullizuesit, viktimat dhe ata të cilët janë njëkohësisht edhe viktimat edhe bullizues, konstatohet se këto kategori janë në rrezik më të lartë ndaj problemeve psikosomatike se bashkëmoshatarët e tjerë të pa përfshire në bullizëm. Probleme të tilla tek fëmijët do të ishin një barrë e madhe në zhvillimin e tyre duke shprehur seriozitetin e dukurisë së bullizmit dhe ndikimit të tij në shoqëri.

Fatkeqësisht, as Kosova nuk është imune karshi këtij fenomeni. Në lidhje me dukurinë e bullizmit në shkolla, YIHR KOSOVA në bashkëpunim me shkollën Xheladin Rekalii dhe me GIZ kanë anketuar 43 nxënës të kësaj shkolle. Rezultatet e këtij anketimi tregojnë se 47% e të anketuarëve kanë qenë të ngacmuar, 51% kanë parë raste të bullizmit, 58% kanë thënë se ngacmimi ndodhë në prani të të tjerëve, 98% mendojnë se djemtë ngacmojnë më shumë se vajzat dhe 42% thonë se vajzat përjetojnë më shumë ngacmime se djemtë, 26% prej tyre thonë se kanë ngacmuar ndonjëherë ndërsa 70% e tyre mendojnë se ngacmuesit prirën të jenë më të dobët në mësim. Në aspektin e formës

së ngacmimit, 40% thonë se forma e ngacmimit ishte me ofendime apo fyerjeve, 11% me thirrje të emrave fyes, si dhe me nga 7% për dhunën fizike dhe marrjen e gjësendeve personale. Gjithashtu në një hulumtim nga Instituti Pedagogjik i Kosovës i cili ka përfshirë matjen e opinionit në nëntë komuna me 380 nxënës dhe 138 mësime të shkollave të mesme, tregohet se gjysma e nxënësve të anketuar, apo 50 për qind e tyre, kanë deklaruar se janë thirrur me emra fyes dhe përqeshur nga të tjerët në baza ditore, javore, mujore apo vjetore; ndërsa 27 për qind kanë deklaruar të jenë shtyrë dhe penguar fizikisht së paku një apo dy herë në vit.

Për më tepër, një hulumtim tjetër i vitit 2021 nga Vrijen. C., tregon se adoleshentët të cilët janë të përfshirë në bullizëm, përkatësisht ata të cilët bullizojnë, janë shumë më të prirë që në të ardhmen e tyre të jenë përdorues të substancave të dëmshme si droga, alkooli, duhani dhe të tjera të ngjashme. Nga këto rezultate shohim se ndikimi i bullizmit nuk është i caktuar në kohë, por ndikimi i tij shtrihet përtej momentit dhe mund të ndikojë

te individët që i janë nënshtruar bullizmit ose kanë bullizuar edhe në periudha afatgjate.

Jeta pas një të kaluarë ku bullizmi ka qenë pjesë e përditshme, nuk është e lehtë, madje ajo mund të jetë shumë e vështirë për tu përballuar dhe jo të gjithë arrijnë që të rikuperohen nga pasojat. Megjithatë, ka disa mënyra efektive të rikuperimit siç është terapia së njohjes-sjelljes. Kjo metodë parasheh përgatitjen fëmijëve për menaxhimin e stresit, zhvillimin e aftësive për relaksimi, krijimin e një narrative koherente ashtu që fëmija të reflektojë mbi ngjarjen traumatike që ka kaluar duke e riparë nga një moment tjetër më i qetë, ndryshimi i pikëpamjeve të gabuara të krijuara nga trauma, përfshirja më e gjerë e prindërve në kalimin e situatës post-traumatike etj. Bullizmi vërejmë se shtrinë ndikimin e tij negativë në shoqëri dhe si i tillë kontribuon në krijimin e situatave problematike, të cilat megjithëse kanë mundësinë e gjetjes së zgjidhjeve për ti kaluar, shpeshherë mbesin ashtu ose edhe arrijnë ekstremin e tyre, duke kaluar në pasoja fatale.



Biondina Muzliukaj

Përballja e komuniteteve jo-shumicë në Mitrovicë me diskriminimin

Diskriminimi konsiderohet si një nga dukuritë më negative në shoqërinë tonë. Diskriminimi paraqet problem për zhvillimin e drejt shoqëror. Prezenca e diskriminimit në shoqëri ndikon në mohimin e dinjitetit njerëzor dhe është në kundërshtim me parimet bazike të të drejtave të njeriut. Sipas legjislacionit aktual në fuqi në Kosovë, diskriminimi përkufizohet si: “Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) [të këtij Ligji], që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësoj ose cenoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës”.

Mitrovica është ndër qytetet më multietnike në Kosovë, ku jetojnë komunitete të ndryshme përfshirë shqiptarë, romë, ashkali, egjiptian, boshnjak dhe serb. Ndër sfidat e mëdha në Mitrovicë por edhe në nivel nacional mbetet diskriminimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Diskriminimi dhe adresimi jo i duhur i gjendjes ekonomike dhe sociale tek këto komunitete nuk ka marrë përgjigje adekuate institucionale dhe kryesisht është trajtuar nga organizatat e ndryshme jo qeveritare dhe mediat. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Njerëzore (KMLDNJ) përmes një interviste për Radio Evropa e Lirë konfirmon se këto

tri komunitete mbeten kategoria më e diskriminuar në vend. Të dhënat zyrtare tregojnë se shumica e familjeve romë, ashkali dhe egjiptian jetojnë me asistencë sociale, megjithatë, sipas hulumtimeve të ndryshme del se edhe kjo asistencë po zvogëlohet për këto komunitete për shkak të kriterëve teknike.

Një fenomen tjetër që i prek në masë këto komunitete janë martesat e hershme. Ndonëse një gjë e tillë është e ndaluar me legjislacionin e vendit, shumë vajza të reja nga këto komunitete detyrohen të lënë shkollat dhe të bëhen pjesë e martesave të hershme, pa dëshirën e tyre. Për më tepër, braktisja e hershme e shkollave nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian është problem më i gjerë dhe hulumtimet tregojnë se pjesa më e madhe e atyre që e braktisin shkollën vijnë nga këto komunitete. Në anën tjetër, ka shumë prej tyre që nuk bëhen pjesë e sistemit arsimor fare dhe detyrohen të kërkojnë lëmshë, nën direktiva të akterëve të kriminit të organizuar. Në këto rrethana, sipas një hulumtimi të KEEN të vitit 2018, del se 55% e punëkërkesve nga këto tri komunitete nuk janë të kualifikuar për treg të punës ndërsa përfshirja e këtyre komuniteteve në aktivitete që synojnë aftësimin profesional ka pësuar rënie vit pas viti.

Diskriminimi dhe pabarazia e komuniteteve rom,

ashkali dhe egjiptian vjen si pasojë e mungesës së vullnetit politik dhe mungesës së efektshmërisë të të gjitha qeverive të Kosovës në adresimin e problemeve bazike të këtyre komuniteteve. Në mënyrë që të mos vazhdohet trendi i stigmatizimit dhe pabarazisë sociale e ekonomike, institucionet

e Kosovës duhet të prioritizojnë problemet e këtyre komuniteteve, t'i adresojnë ato në mënyrë adekuate dhe rrjedhimisht të forcojnë kohëzisionin shoqëror në mes komuniteteve të ndryshme në Kosovë.



Gjenisa Mandal

Sfidat e komunitetit për shëndetin publik – Rasti i COVID-19

Situata me pandeminë COVID-10 vazhdon të jetë një sfidë e paparë dhe konstante për shëndetin publik, sistemet e shërbimit ushqimor si dhe për punëtorët në përgjithësi në Kosovë. Secili aspekt i jetës dhe punës ditore së qytetarëve të vendit është prekur. Shumica kanë pësuar një ndryshim të rëndë dhe kryesisht negativ në fushat ekonomike, akademike, shëndetësore dhe psikologjike të përditshmërisë së tyre. Secila grup-moshë hasi në problematika të ndryshme, shumica e të cilave vazhdojnë e shfaqen si të pazgjithura apo të pashmangshme. Në veçanti, të rinjtë mund të themi se përjetuan një ndryshim në dinamikën e tyre jetësore, duke marrë parasysh faktin që në vetvete periudha e adoleshencës dhe rinisë konsiderohet si një moshë delikate dhe sensitive, që përmban ndryshime të shumta shoqërore dhe në gjendjen emocionale personale. Rrjedhimisht, periudha e pandemisë ka pasur ndikim të dukshëm në aspektin psikologjik të këtyre kategorive.

Duke marrë parasysh që jeta sociale e të rinjve varet nga ndërveprimet personale shoqërore, masat për parandalimin e përhapjes të mëtutjeshmetë COVID-19, kanë reduktuar ndërveprimin dhe kontaktin ndërmjet të rinjve. Nevojën për prezencë në mediat sociale që solli teknologjia bashkëkohore në ndërveprim shoqëror ka bërë që jeta sociale të varet edhe nga rrjetet sociale. Kështu, përveç izolimit fizik, pjesëmarrja e gjerë në rrjete sociale ka rritur ekspozimin e të rinje ndaj rreziqeve potenciale që përmban përdorimi i rrjeteve sociale, siç është bullizmi kibernetik. Duke qenë se gjatë periudhave të ndryshme të izolimit gjatë pandemisë

përdorimi i mjeteve teknologjike dhe rrjeteve sociale është rritur edhe më tej, ekspozimi i papushuar i të rinjve në rrjete sociale potencialisht sjell edhe pasoja tjera shtesë si përkeqësimi i shëndetit të syve, ankthi etj. Në të njëjtën kohë, edhe cikli i gjumit, rregullsia e të cilit është shumë e rëndësishme për zhvillimin e të rinjve, është dëmtuar. Në anën tejtër, duke marrë parasysh që më të rrezikuarit nga COVID-19 janë të moshuarit, izolimi ka goditur edhe shëndetin mendor të tyre. Frika në njërin anë dhe izolimi nga të afërmit e tyre në anën tjetër ishte sfidë e dyfishtë me të cilën u përballën të moshuarit, dhe rrjedhimisht u rrit potenciali për depresion dhe ankth te kjo kategori. Për më shumë, shoqëria dhe shteti nuk e ka dhënë përgjigjen adekuate për nevojat e kësaj shtrese shoqërore.

Pandemia dëmtoi shumë rëndë edhe ekonominë e vendit. Thellimi i problemit të papunësisë pati ndikim tek secili individ dhe secila familje, duke ndryshuar qasjen me njëri-tjetrin si dhe planifikimet ekonomike dhe familjare të tyre. Në bazë të hulumtimeve të ndryshme, shumica prej atyre që i humbën vendet e punës shfaqen shenja të depresionit, pesimizmit të shtuar dhe agresivitetit. Për më tepër, duke qenë se familjet Kosovare janë të lidhura ngushtë me anëtarët e familjes nga diaspora dhe një pjesë e ekonomive të tyre varen nga ata, mungesa e mundësisë së udhëtimit preki edhe më tutje aspektin ekonomik dhe shoqëror të këtyre familjeve.

Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm ku pandemia dhe masat e ndërmarra për parandalimin e saj patën

efekt të madh është edukimi. Në rrethanat e krijuara, shkollat dhe universitetet u detyruan që ta transferojnë procesin mësimor në platforma të ndryshme virtuale. Në këtë aspekt, u ngritën pikëpyetje për efektshmërinë e mësimin online dhe mësim-nxënien sidomos tek moshat më të reja. Për më tepër, duke qenë se një element i rëndësishëm i formësimit në edukim është edhe ndërveprimi me nxënës dhe studentë tjerë, një aspekt tjetër negativ i kësaj forme të mësimin është pamundësia e ndërveprimit dhe koordinimit me nxënës dhe studentë tjerë për procesin arsimor dhe aktivitetet e ndryshme ekstra-kurikulare.

Në përgjithësi, kjo pandemi solli në pah mungesën e kapaciteteve tona shtetërore për tu ballafaquar me fenomene të tilla, sidomos në fushën e ekonomisë

dhe kualitetin e shërbimeve mjekësore në vend. Mënyra më e mirë për tu ballafaquar këto probleme është t'i përgjigjemi të metave të sistemit aktual në mënyrë të efektshme dhe vizionare. Kjo do të arrihet me bashkëpunim të ngushtë të komunitetit me institucionet e ndryshme dhe përballjes me mungesat dhe dëmet e shkaktuara deri më tash. Komuniteti duhet të respektojë masat si distanca, vendosja e maskës etj. në mënyrë që të lehtësojë punën e sistemit shëndetësor dhe të kontribuojë në hapjen graduale të ekonomisë. Në anën tjetër, institucionet duhet të kenë prioritet sigurimin e vaksinave dhe vetëdijësimin e vazhdueshëm të qytetarëve, duke e mbajtur një nivel më të lartë transparence për punën e tyre në fushën e shëndetit publik në përgjithësi.



Fleta Qetaj

Përballja e komunitetit me dhunën ndaj gruas

Dhuna ndaj grave është një shkelje e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe një manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis burrave dhe grave. Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje përcakton aktet e dhunës në familje, si: *“vepra apo lëshime të qëllimshme që i bënë një person personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare”*. Akte të tilla mund të përfshijnë forcën fizike, presionin psikologjik, kërcënimin e anëtarëve të familjes, ndjelljen e frikës, cenimin e dinjitetit, sulmin fizik, ofendimet, frikësimin, aktet seksuale pa pëlqim, kufizimin e lirisë së lëvizjes, dëmtimin e pronës, hyrjen apo largimin me dhunë nga banesa e përbashkët apo banesën e personit tjetër, dhe rrëmbimin. Shumë prej këtyre akteve gjithashtu përkufizohen si krime në kuadër të Kodit Penal të Kosovës. Nuk ka rëndësi nëse këto akte ndodhin brenda familjes, ‘prapa dyerve të mbyllura’, ato janë prapëseprapë të paligjshme dhe duhet të ndiqen penalisht në përputhje me ligjin.

Të dhënat e Policisë së Kosovës tregojnë se në mes të viteve 2009 dhe 2017, numri i rasteve të raportuara të dhunës në familje në Kosovë ka qenë mes 944 dhe 1269. Gjatë kësaj periudhe, nuk ka pasur shumë luhajtje dhe ndryshime. Këto të dhëna tregojnë se dhuna në familje në Kosovë mbetet shumë pak e raportuar. Shkalla aktuale e rasteve të dhunës në familje shkon deri në 68% për gra dhe 56% për burra, që tregon se rastet e dhunës në familje raportohen rrallë në Policinë e Kosovës. Por, të dhënat e siguruar nga Policia e Kosovës tregojnë disa gjëra interesante për vitet 2018 dhe 2019. Për herë të parë që nga viti 2009, shkalla e raportimit të dhunës në familje është rritur në mënyrë drastike. Në vitin 2018, janë raportuar gjithsej 1533 raste, që

shënojnë një rritje prej 20.8% krahasuar me një vit më parë dhe një rritje prej 25.1% krahasuar me dy vjet më parë. Raportimi i shtuar nuk tregon rritje të rasteve të dhunës në familje. Përkundrazi, kjo duhet të shihet si shenjë pozitive që tregon se një numër më i madh i viktimave po i raportojnë krimet e dhunës në familje. Në Kosovë, ashtu si në mbarë botën përgjithësisht, dhuna ndaj grave përfaqëson formën më të përhapur të dhunës, ku kryesit e veprave penale janë më së shumti burrat e tyre apo anëtarët tjerë të familjes.

Pabarazitë gjinore janë të rrënjosura në normat patriarkale. Një studim i OSBE/UNFPA i vitit 2018, i quajtur *“Këndvështrimi i burrave mbi barazinë gjinore në Kosovë”* tregoi se qëndrimet tradicionale ende mbizotërojnë. Hulumtimi i *Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK)* i vitit 2018, tregoi se 21% e kosovarëve pajtohen se “ndonjëherë është në rregull që burri ta godas gruan”. 53% mendojnë se “në qoftë se burri është i papunë, dhuna edhe mund të ndodhë ndonjëherë”. 24.6% besojnë se “marrëdhënia seksuale e detyrueshme nuk mund të konsiderohet dhunë nëse ajo ndodh midis dy të rriturve të cilët janë të martuar”. 45.8% nuk e konsiderojnë formën të dhunës “kontrollin mbi personin se ku mund të shkojë e ku jo”. 33.9% mendojnë se është “e natyrshme që dhuna në familje ndodh kur dikush pi alkool”. Fatkeqësisht, thirrjet për dominim gjinor vijnë rregullisht. Ato vijnë përmes diskursit publik që nxit t’i urrejmë gratë, t’i përcëmojmë, t’i reduktojmë në epitete mizogjene e emra kafshësh, t’i ofendojmë e kërcënojmë haptas e publikisht edhe në Kuvend, t’i ndëshkojmë e përjashtojnë në momentin që devijojnë nga normat konvencionale gjinore të ‘gruas së ndershme’.

Gratë vazhdojnë të përfaqësojnë shumicën dërrmuese të viktimave të dhunës në familje edhe në Komunën

e Pejës dhe shumicën e viktimave që raportojnë krimin. Tutje, të dhënat e marra nga Policia e Kosovës konfirmojnë natyrën gjinore të krimeve të dhunës në familje. Të dhënat e policisë tregojnë se në vitin 2019, totali i të gjitha rasteve të raportuara të dhunës në familje në Pejë ishte 156, të cilat përfshinin 130 femra ndërsa vetëm 26 meshkuj si viktima të dhunës në familje. Nga kjo del se nga gjitha rastet e dhunës në familje në Pejë në 83.33% prej tyre viktimat ishin femra, përdërisa rreth 55.77% të rasteve të dhunës ishin nga marrëdhëniet bashkëshortore, 2.56% nga bashkëjetesa, 5.76% nga marrëdhënia nënë - djalë, 3.85% nga marrëdhënia vëlla - motër. Në anën tjetër, në vitin 2020 në Pejë janë raportuar 165 raste të dhunës në familje, me mbi 80% të viktimave femra.

Si një shkelje e gjerë e të drejtave të njeriut, dhuna në baza gjinore meriton përparësi të plotë institucionale. Reagimi i duhur nga të gjitha institucionet relevante, sidomos ato të drejtësisë është e rëndësishme jetike për të luftuar këtë dukuri pandemike. Sidoqoftë, institucionet publike në Kosovë kanë dështuar vazhdimisht për të mbrojtur viktimat e dhunës në bazë gjinore. Kjo përfshin disa vdekje të dhunës në familje, lëndime të

rënda trupore, dhunim, sulm seksual që ndodhën si rezultat i drejtpërdrejtë i dështimit institucional për të mbrojtur viktimat. Reagimi i institucioneve publike kompetente ose mund ta inkurajojë viktimën drejt vazhdimit të veprimeve juridike kundër kryesit ose mund ta dekurajojë atë dhe të detyrojë të heqë dorë nga ndjekja penale dhe të rrit tutje traumat potenciale që veçse mund t'i kenë viktimat.

Kështu viktimat rrallëherë bëjnë kallëzim për dhunën seksuale, përfshirë përdhunimin, që ndodh brenda dhe jashtë familjes apo njësisë shtëpiake. Stigma sociale që lidhet me këtë formë të dhunës do të thotë se viktimat, të cilat dalin publikisht, përballen me izolimin që i bën shoqëria, mospranimin nga ana e pjesëtarëve të familjes dhe gjykimin si të papërshtatshme për martesë. Një stigmatizim i tillë, bashkë me mungesën e pranimit dhe korrigjimit nga ana e autoriteteve gjithashtu, ka penguar edhe shumë gra viktima të dhunës seksuale gjatë luftës të vitit 1999 që të kërkojnë shërbime mbështetëse dhe drejtësi. Dhuna ndaj grave është realitet i formësuar politikisht që mirëmbahet nga institucionet patriarkale dhe kërkon mobilizim dhe përgjigje të gjerë gjith-shoqërore.

